



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUIQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA



RAPORTI VJETOR 2020

Të jetojmë nga toka dhe puna jonë

Përmbajtja

1. Përmbledhje nga të arriturat.....	6
2. Profili i organizatës.....	8
3. Partnerët dhe Donatorët e IADK-së.....	8
4. Sektori i përpunimit me potencial të lartë për përfshirje të grave në aktivitete ekonomike.....	9
5. Kultivimi, grumbullimi dhe tharja e bimëve medicinale dhe aromatike mundësi për të synuar tregun ndërkombëtarë e që rezultojnë me punësim dhe gjenerim të të ardhurave për përfituesit.....	11
6. Perimtaria si një sektor vital për punësim dhe gjenerim të të ardhurave.....	14
7. Pemëtaria ofron mundësi punësimi dhe gjenerimi të të ardhurave për të gjithë gjeneratat.....	15
8. Blegtoria si një sektor premtues dhe me potencial për punësim dhe gjenerim të të ardhurave.....	16
9. Strategjia e IADK-së, Objekti i përpunimit dhe Validimi nga Autoritetit Kombëtar i Kualifikimeve.....	17
10. IADK përmes fondeve të BE-së përkrah zhvillimin e turizmit dhe krijimin e vendeve të punës për të rinjtë dhe gratë përmes zhvillimit të bujqësisë.....	19
10.1 Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm të Kosovës në zonën rurale.....	19
10.2 Krijimi i vendeve të punës në bujqësi.....	19
10.3 Mbështetja në punësimin e të rinjëve dhe grave në zonat rurale përmes zhvillimit të bujqësisë.....	20
11. IADK ka zgjeruar gamën e operimit duke analizuar sektorin e pylltarisë.....	21
12. Përmbledhje të rezultateve.....	21
13. Ngritja e kapaciteteve profesionale.....	21
13.1 Fuqizimi i fermerëve përmes këshillave direkte dhe trajnimeve profesionale.....	21
13.2 Zhvillimi i bujqësisë kërkonë një staf të trajnuar sipas standardeve.....	22
14. Publikimet.....	22
15. Vizitat lokale dhe regjionale.....	23
16. Eventet për diskutim, identifikim dhe adresim të problemeve, promovim dhe publikim të aktiviteteve.....	23
17. Të hyrat e IADK-së nga donatorët për vitin 2020.....	24
18. Të hyrat e IADK-së nga partnerët për vitin 2020.....	25
19. Lista e stafit të IADK-së për vitin 2020.....	26

Të nderuar lexues,



Bujqësia vazhdon të jetë një nga shtyllat kryesore në krijimin e mundësive për punësim dhe gjenerim të të ardhurave për popullësinë, e në veçanti për komunitetin që jeton në zonat rurale të Kosovës. Adresimi i kërkesave për zhvillim të bujqësisë, padyshim që kërkon ndërtimin e partneritetit dhe bashkëpunimit me të gjithë akterët, në këtë drejtim IADK ka treguar së është një partner serioz bashkëpunues për donatorët dhe fermerët. Transparenca dhe llogaridhënja si gjithmonë kanë karakterizuar IADK, me ç'rast ka ndikuar në fuqizimin e partneritetit me donatorë dhe padyshim rritjen e numrit të përfituesve.

Vitin që po e lëmë pas, padyshim që ka qenë një vit mjaft sfidues për zhvillim të bujqësisë, i ndikuar nga pandemia dhe masat e marra si rezultat i luftimit të Covid 19. Pavarësisht vështirësive, për IADK-në viti 2020 ka qenë një vit rekord si në përkrahjen nga donatorët, partnerët gjithashtu edhe me numër të rritur të punonjësve dhe përfituesve si dhe me përmirësimin e infrastrukturës dhe ambientit në zyret e IADK-së. Ne mbesim të përkushtuar në realizimin e aktiviteteve me qëllim që të jemi sa më afër fermerëve, të rinjëve, grave, minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara.

Ne vazhduam të realizojmë vizionin që kemi ndërtuar, duke mbështetur fermerët në modernizimin e bujqësisë, duke rritur gjithëpërfshirjen dhe duke krijuar qëndrueshmëri në aspektin mjedisor. IADK mbetet e përkushtuar në promovimin dhe zhvillimin socio-ekonomik në zonat rurale, në zvogëlimin e papunësisë dhe krijimin e mundësive për gjenerim të të ardhurave etj.

Si zakonisht, IADK me stafin e saj të përkushtuar ishte gjithmonë pranë fermerëve, personave që me të vërtet mendojnë të zhvillojnë bujqësinë, prandaj krahas zhvillimit të bujqësisë të kenë mundësi të rrisin të ardhurat dhe krijojnë vende pune.

Për të arritur këto objektiva, IADK ka mbështetur një numër të madhë të fermerëve në zonat rurale dhe gjysmë rurale, duke përmirësuar dhe zhvilluar sektorët dhe nënsektorët më me potencial siç janë: pemëtaria, perimtaria, blegtoria, bletaria, BMA, përpunimi i frutave dhe perimeve etj.

Gjatë këtij viti ne krijuam mundësi punësimi dhe gjenerimi të të ardhurave për 239 përfitues, ne i ofruam mundësi që gratë dhe rinia si një nga grupet më të pafavorizuar të përkrahen nga IADK përmes granteve, trajnimeve dhe vizitave.

Për IADK-në, bujqësia mbetet një nga shtyllat kryesore për zhvillim, punësim dhe gjenerim të të ardhurave, prandaj ne do të mbesim të përkushtuar të mbështesim bujqësinë, do të përgatisim fermerët tanë të vyshëm që të rrisin prodhimin, të përmirësojnë cilësinë dhe të bëhen pjesë e familjes së madhe Evropiane.

Si drejtor i organizatës, në emër të bordit të drejtorëve dhe stafit të organizatës do jemi falenderues për punën e përbashkët, për bashkëpunimin dhe kontributin e ofruar në zhvillimin e më tutjeshëm të bujqësisë.

I juaji

Zenel Bunjaku

1. Përmbledhje nga të arriturat



25 pika grumbulluese dhe kultivuese janë mbështetur me tharëse termike me sipërfaqe 40m² secila



54 përfitues, kultivues të bimëve medicinale aromatike janë mbështetur me mekanizëm dhe paisje përcjellëse për kultivimin e BMAve në sipërfaqe 13.5 ha



13 pika tharrëse janë mbështetur me motokultivator, serra dhe inkubatorë për kultivim të fidaneve



Janë mbështetur 2 përfitues në kultivimin e dredhëzës dhe boronicës me të gjithë inputet përcjellëse. 1 me sipërfaqe me dredhëz prej 15 ari dhe 1 përfitues me boronicë sipërfaqe 26 ari.



Janë mbështetur 63 përfitues me serra, sipërfaqe prej 100, 160 dhe 200 m²




3 biznese të mbështetur për punësim të grave në përpunim të frutave, perimeve, qumështit dhe prodhim të ëmbëlsirave



Janë mbështetur 8 bletarë me paisje të nevojshme për bletari



69 përfitues janë mbështetur me mekanizëm bujqësorë në sektorin e blegtorisë, pemtarisë dhe perimeve, me qëllim rritjen e produktivitetit dhe sipërfaqeve punuese





2 përfitues janë mbështetur me inkubator për çelje të zogjëve



30 të rinjë, student të diplomuar në fushën e bujqësisë dhe pëpunimit kanë përfunduar praktikën në punë



11 vende të punës të krijuar për agronomët e rinjë si rezultat i praktikës në punë



Këshilla Direkte
206 përfitues kanë ndjekur 739
këshilla direkte

Trajnime Profesionale
304 përfitues kanë ndjekur
417 këshilla profesionale

**Trajnime për Fermerë
certifikim Organik**
54 përfitues kanë ndjekur 54
këshilla për certifikim organik

**Trajnim për të drejtat
pronësore**

31 përfitues kanë ndjekur 110
këshilla për të drejtat
pronësore

**Trajnime për
student – të rinjë**
60 të rinjë-studentë kanë
ndjekur 300 sesione
trajnimi

**Trajnim për pikat
Grumbulluese –
certifikim organik**

7 pika grumbulluese kanë
ndjekur 7 trajnime në certifikim
organikë



35 përfitues kanë shtuar
të hyra nga 200 deri 1,000
EURO



62 përfitues kanë
gjeneruar të hyra nga
1,001 deri 1,600 EURO



25 përfitues kanë
gjeneruar të hyra mbi
1,600 EURO



25 pika grumbulluese nga
përdorimi i tharsëve
termike kanë gjeneruar
nga 8,500 EURO

2. Profili i organizatës

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) është një organizatë jo profitabile, jo qeveritare e themeluar në vitin 2004. Misioni i organizatës është të promovojë zhvillimin socio ekonomik në zonat rurale, të zvogëlojë papunësinë dhe të krijojë të ardhura ekonomike, duke zvogëluar migrimin e popullësisë në zonat urbane. Synon grupet më në nevojë, duke mbështetur fermerët, ata të cilët kanë të hyra të ulëta dhe jetojnë në kushte të vështira ekonomike, mbështetë të rinjtë dhe studentët duke përgatitur ata për tregun e punës, dhe padyshim një fokus grup me interes janë gratë, minoritetet dhe grupet e marginalizuara. IADK ka për qëllim të ndikojë në zhvillimin e bujqësisë, duke adresuar problemet në sektorët bujqësorë që do të rezultojë në përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së produkteve bujqësore, ngritjen e shkathtësive, konkurrencës së fermerëve dhe fuqizimin e rolit të tyre. Për këtë qëllim, IADK ka një bashkëpunim të suksesshëm me fermerët, shoqatat e fermerëve, zyrtarët komunal dhe qeveritarë. Qëllimi primar i organizatës është rritja e konkurrencës në treg, ofrimin e praktikave të mira bujqësore dhe të përpunimit, dhe promovimin dhe zbatimin e standardeve të BE-së. Organizata përbëhet nga një ekip profesional, me një ekspertizë në fushat e ndryshme të bujqësisë dhe mbulon tërë territorin e Kosovës. IADK ka një bashkëpunim të suksesshëm me donatorë të shumtë nga Bashkim Evropian, Qeveria Gjermane, Zvicerane etj.

3. Partnerët dhe Donatorët e IADK-së

IADK ka ndërtuar një partneritet strategjik dhe të qëndrueshëm me donatorë dhe partnerë në nivel vendi dhe ndërkombëtar. Zhvillimi dhe fuqizimi i IADK-së është falë bashkëpunimit, profesionalizimit dhe përgjegjshmërisë që stafi i saj ka treguar me donatorë dhe partnerë të ndryshëm. IADK vazhdon të jetë një lider i zhvillimit të bujqësisë në Kosovë dhe përkrahjes së fermerëve. Krahas projekteve ekzistuese, IADK ka nënshkruar kontrata me 3 projekte të reja të Bashkimit Evropian dhe kontrata të tjera për shërbime si me Swiss Caritas, FAO etj. Në vitin 2020 IADK ka vazhduar të zbatojë projektet e mëposhtme me përkrahje nga donatorët e ndryshëm:

- **Brot für die Welt (BfdW):** "Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës"
- **GIZ:** "Mbështetja e zinxhirit të vlerave të BMA përmes krijimit të punësimit dhe vazhdimin të eksportit"
- **DRC:** "Mbështetja e Ndërmarrësisë Shoqërore dhe Promovimi i Fuqizimit Social-ekonomik në Komunitetet Minoritare në Kosovë"
- **EU BMA:** "Krijimi i punësimit në bujqësi"
- **EU Turizëm:** "Tranushumanca - ofertë e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi"
- **EU VET:** "Mbështetja e punësimit të të rinjëve dhe grave në zonat rurale përmes zhvillimit të bujqësisë"
- **Swiss Caritas:** Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Gjithpërfshirës Ekonomik Rural (SIREd).
- **UNDP:** "Mbështetja e grave dhe vajzave në fuqizimin ekonomik përmes vetë-punësimit dhe ngritjes së aftësive të tyre profesionale" – Projekti ka përfunduar më 25.01.2020.
- **GIZ** "Përfshirja ekonomike e të riatdhesuarve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve profesionale" – Projekti ka përfunduar më 15.08.2020
- **FAO:** "Mbledhja e të dhënave për krijimin e bazës për ligjshmërinë e drurit dhe aspektin ekonomik të sektorit pyjor në Kosovë" - Projekti ka përfunduar më 31.10.2020.
- **CFD:** "Trajnimi profesional dhe mundësitë për gjenerimin e të ardhurave në bujqësi për gratë dhe të rinjtë që jetojnë në zonat rurale të Kosovës" – Projekti ka përfunduar më 31.12.2020.

IADK vazhdon të jetë pjesë e rrjeteve në nivel të Kosovës siç janë: RRGK, CiviKos si dhe ato në nivel të BE: EUFRAS dhe SEASN, ku IADK-ja është anëtar i bordit si dhe nënkryetar i rrjetit.

4. Sektori i përpunimit me potencial të lartë për përfshirje të grave në aktivitete ekonomike

Fuqizimi i grave si në aspektin social dhe ekonomik mbetet ende një sfidë që duhet të adresohet përmes projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme. Inkurajimi i grave për përfshirje në aktivitete të tilla padyshim që kërkon një punë të konsiderueshme nga të gjithë akterët e në veçanti nga niveli kombëtar. Gratë, në veçanti ato që jetojnë në zonat rurale vazhdojnë të diskriminohen në aspektin ekonomik si brenda familjes ashtu edhe shoqërisë. Papunësia vazhdon të jetë mjaftë e shprehur, sipas të dhënave statistikore papunësia në nivel të Kosovës për gratë vazhdon të jetë në 31% krahasuar me burrat që është 23%. Bujqësia dhe degët e saj mbetën një nga mundësitë për të adresuar çështjen e papunësisë, megjithatë gratë vazhdojnë të marrin paga më të ulëta dhe kanë një pjesëmarrje më të ulët në fuqinë punëtore në secilin nivel të arsimit, në industri e me theks të veçantë në sektorin e bujqësisë. Sipas të dhënave statistikore, vetëm 12% e të punësuarave në bujqësi janë gra krahasuar me burrat që përbëjnë 88%.

Për adresim të këtyre çështjeve, padyshim një rol të rëndësishëm luan organizata IADK duke dizajnuar programe adekuate për involvim dhe punësim të grave në zonat rurale. Në këtë drejtim, janë përkrahur gratë për hapjen e 3 bizneseve në përpunim të qumështit, frutave – perimeve dhe ëmbëlsirave.



Përpunimi i qumështit - krijimi i kushteve të përshtatshme për përpunimin e qumështit është esenciale për përgatitjen e produkteve të sigurta për konsumatorët. Kjo mundësi iu ofrua Znj. Aferdita Ademi nga fshati Lubishtë, Komuna e Vitisë duke bërë të mundur funksionalizimin e pikës përpunuese përmes paisjeve të nevojshme për pranimin e qumështit, trajtimin, përpunimin, ruajtjen dhe higjienën e hapësirave punuese. Prodhimi i produkteve cilësore nga përdorimi i infrastrukturës së nevojshme, kërkon edhe një marketing të mirëfilltë, prandaj IADK ka mbështetur këtë biznes përmes sigurimit të barkodeve dhe dizajnimin e llogos dhe etiketave, një mbështetje e tillë do të mundësojë që zonja të plasoj produktet në treg.

Përgatitja e ëmbëlsirave – përveç përkrahjes së grave në sektorin e përpunimit, IADK përmes projekteve të shumta ka vënë si prioritet edhe fuqizimin e të rinjëve dhe zhvillimin drejt qëndrueshmërisë ekonomike. Në këtë vit një mundësi e tillë iu ofrua Adelina Feratit nga fshati Bare, Komuna e Mitrovicës e diplomuar në fakultetin Inxhinieri Ekonomi. Përkundër studimeve, Adelina ka vendosur që përmes përkrahjes nga IADK të vetëpunsohet dhe të krijojë mundësi edhe për vajza të tjera të cilat kanë vështirësi për qasje në vende të punës. Përgatitja e ëmbëlsirave, është sektori që ajo është orientuar dhe pas vijimit të trajnimeve profesionale në IADK, ajo është përkrahur me pajisje për përgatitjen, pjekjen dhe ruajtjen e ëmbëlsirave. Adelina ka arritur që ta hap biznesin e saj "Adelina's cake" ku përgatit ëmbëlsira dhe biskota të ndryshme sipas porosisë.



Njësia për përpunimin e frutave dhe perimeve mundësi për punësim dhe gjenerim të të ardhurave për gratë në zonat rurale

Vjosa Rexhaj Ferizi, si shumica e grave jeton në zonën rurale në Komunën e Vushtrrisë, ku përfshirja e tyre në marrjen e vendimeve për jetën dhe të ardhmen e tyre është e limituar.



Sidoqoftë, si një grua e arsimuar dhe e diplomuar në fakultetin e Matematikës, Vjosa gjithmonë mendonte të përmirësonte jetën e saj dhe grave të tjera në komunitetin e saj. Vjosa, me bindjen dhe vullnetin që kishte shfrytëzoi më së mirë mundësitë që ofronte IADK ku rregullisht përcejeli trajnimet profesionale të përpunimit të frutave dhe perimeve. Meqenëse interesi i saj ishte shumë i madh për punësim, ajo shprehu gatishmërinë që të aplikoj në grantin që ofronte IADK, për të cilën me shumë meritë ajo u përzgjedhë përfituese. Dëshira që të filloj këtë biznes jetik për të, ka bërë që Vjosa të bëjë investime substanciale në ndërtimin e objektit për vendosjen e njësisë së përpunimit. Një punë e tillë padyshim që ka shtyrë IADK-në që të mbështesë atë me hapjen e pikës përpunuese, duke investuar në pajisje moderne për përpunim të frutave dhe perimeve. Për një kohë të shkurtë Vjosa ka arritur që të vendos në funksion njësinë duke përpunuar 6510 kg fruta e perime me një vlerë prej mbi 10,000 euro. Jo vetëm kjo, Vjosa për shkak të shtimit të vëllimit ka arritur të punësojë edhe katër gra nga rrethi i saj, duke ju mundësuar që edhe ato të krijojnë të ardhura për vete dhe familjet e tyre.

Si një fillestare, por me ambicie të mëdha, Vjosa sot zotëron dhe menaxhon biznesin e saj me emrin "Nature Traditional Taste", duke përpunuar fruta dhe perime të cilat i plasojnë në tregje të ndryshme, kryesisht supermarkete. Produktet e saja (recel, xhem, specia turshi, ajvar, feferon etj) janë të një cilësie të lartë ushqimore.

Vjosa është falenderuese për mbështetjen, sot ajo ka një përkrahje të pakursyer nga familja sa që është një nga pak gratë që ka arritur të jetë pronare e biznesit dhe tokës e bartur nga familja. Vjosa është shembull i një gruaje të suksesshme, një model që do të përvetësohet edhe nga gratë e tjera që jetojnë në zonat rurale.



5. Kultivimi, grumbullimi dhe tharja e bimëve medicinale dhe aromatike mundësi për të synuar tregun ndërkombëtarë e që rezulton me punësim dhe gjenerim të të ardhurave për përfituesit



Në përgjithësi bujqësia konsiderohet si një ndër kontribuesit e rëndësishëm në bruto produktin vendor me rreth 7.7% dhe punëson përafërsisht 25% të fuqisë punëtore, prandaj konsiderohet si një nga sektorët mjaft të rëndësishëm ekonomik. Një rol të rëndësishëm luan edhe sektori i Produkteve Pyjore Jo Drusore dhe Bimët Medicinale e Aromatike si një nënsektor i bujqësisë me potencial të lartë për eksport.

Në këtë kontekst, Kosova ofron kushte të përshtatshme për grumbullim dhe kultivim të shumëllojshëm të bimëve medicinale dhe aromatike. Këto kushte të përshtatshme, padyshim që janë duke u shfrytëzuar në mënyrë shumë racionale nga fermerët tanë të vyshëm duke rritur sipërfaqet, përmirësuar cilësinë dhe duke rritur eksportin e produkteve. Në këtë drejtim një rol substancial luan IADK përmes projekteve të saj që identifikojnë dhe adresojnë çështjet për zhvillim të vazhdueshëm të BMAve. Përmirësimi i sasisë, cilësisë dhe eksportit të BMAve përfshirë edhe




rritjen e punësimit ishin objektivat e IADK-së në këtë sektorë. Prandaj, gjatë këtij viti ky sektor kishte një vëmendje të veçantë me ç'rast 54 fermerë nga të cilët 46 meshkuj dhe 8 femra u mbështetën me sisteme të ujijtes, serrë tharëse dhe motokultivator me paisje për punë. Të rinjtë e moshës 18-35 dhe minoritetet ishin target grupe përfituese e IADK-së, prandaj nga totali i përfituesve 19 nga ta ishin të rinjë dhe 5 nga komuniteti jo shumicë. Një mbështetje e tillë mundësoi që këta fermerë të kultivojnë bimë medicinale dhe aromatike, kryesisht Hithër, Lule Diell

dhe Kalendulë në sipërfaqe totale prej 13.5 ha. Një sipërfaqe e tillë ka mundësuar prodhimin dhe tharjen e përafërsisht 10 ton bimëve medicinale dhe aromatike.

Krahas mbështetjes për rritjen e sasisë dhe cilësisë së prodhimit nga fermerët, IADK ka dhënë një kontribut substancial edhe në përmirësimin e kushteve të tharjes së bimëve, prodhim të materialit fidanor, mekanizmit bujqësor duke mbështetur 38 pika grumbulluese. Gjatë viteve të fundit, pothuajse të gjithë pikat grumbulluese janë ballafaquar me kostot e larta të tharjes dhe humbje të energjisë si rezultat i përdorimit të tharësve të pa përshtatshme. Prandaj, IADK duke parë këtë si një nga shkaqet dhe vështirësitë për grumbulluesit, ka përkrahur 25 nga pikat grumbulluese me tharëse moderne termike me sipërfaqe prej 40m². Përfitimet nga këto tharëse janë të shumta, përfituesit kanë arritur të zvogëlojnë kostot e tyre të tharjes, në veçanti në kursim të energjisë deri 70%. Një investim i tillë ka ndihmuar që përfituesit të bëjnë tharjen e 62 ton produkte që prodhohen dhe grumbullohen nga fermerët. Pikat grumbulluese dhe tharëse nga shitja e produkteve të thara kanë arritur të shesin mbi 210,000 euro produkte për tregun vendor dhe ndërkombëtar.

Ofrimi i trajnimeve profesionale dhe praktike është vlerësuar si mjeti kryesor për të arritur objektivat nga përfituesit, prandaj fermerët ashtu edhe pikat grumbulluese janë përkrahur me këshilla praktike dhe profesionale me qëllim shfrytëzimin sa më racional të grantit dhe arritjes së objektivave në cilësi dhe sasi më të lartë, gjenerim të vendeve të punës, rritje të ardhurave dhe eksport të produkteve në tregun ndërkombëtar.





Kombinimi i ofrimit të grantit me këshilla praktike profesionale, monitorime e vizita studimore, padyshim që kanë rezultuar me të arritura të pritshme. Disa nga pikat kanë filluar diversifikimin e produktit final duke prodhuar çajra organike, kanë arritur të shtojnë sasinë e produkteve për tregun ndërkombëtar, kanë përmirësuar formën e shitjes së produkteve duke kaluar në shitjen online të produktit.

Krahas mbështetjes, një rëndësi kryesore i është dhënë edhe çertifikimit organik, prandaj 54 fermerë janë pajisur me dosje për mbajtje të shënimeve për certifikim organik. Njëkohësisht, nga 25 pika grumbulluese, 4 janë ndihmuar në proces të certifikimit ku 2 prej tyre janë certifikuar dhe 2 të tjera janë në proces të certifikimit.



Bujqësia për Shkëlqimin Morina ka qenë gjithmonë puna kryesore me të cilën ka mbajtur familjen. Në një sipërfaqe 3ha ka prodhuar bimë lavërtare dhe ka mbajtur lopë qumështore, nga kjo punë ai nuk ka qenë i kënaqur, prandaj ka hulumtuar mundësi të reja që do të rezultojnë me të hyra më të larta për të dhe familjen. Si punëtor i ri, i vullnetshëm e entuziast, Shkëlqimi është mbështetur nga IADK me tharëse moderne prej 40m², motokultivator me frezë e kosë për të lehtësuar punën në kultivimin e BMAve. Një mbështetje e tillë ka mundësuar që ai të kultivoj Hithër në sipërfaqe 0.50 ha dhe Mentë 1.30 ha. Nga

kjo sipërfaqe ka arritur të vjelë dhe thaj 1800kg hithër dhe 5878 kg mentë, të cilat i kanë siguruar rreth 13,000.00 euro të ardhura. Në tharësen termike bashkëkohore ka bërë rreth 17 tharje nga prodhimi i tij dhe rreth 11 (rreth 4500kg i tharë) tharje nga prodhimi i fermerëve të rrethinës. Përveç mbështetjes me grant, Shkëlqimi është pajisur edhe me njohuri të duhur të ofruar nga ekspertët e IADK-së. Ai ka arritur të shfrytëzojë grantin dhe këshillat në mënyrë racionale, prandaj sot është një ndër prodhuesit më të mirë të BMA-ve. Ai ka krijuar një lidhshmëri të mirëfilltë me eksportuesit kryesorë në vend, një mundësi të tillë ka krijuar tharësja më bashkëkohore e ofruar nga IADK. Sot, Shkëlqimi si një i ri është shembull për gjeneratat e reja, për të gjithë ata që e vlerësojnë sektorin e BMA-ve si një sektor mjaft profitabil. Ka filluar si prodhues fillestar, por sot ka bërë mbjelljet vjeshtore me BMA me një sipërfaqe prej 3ha me kulturën e Mentës dhe Hithër prej të cilave ka marrë në shfrytëzim 0,5 ha, nga kjo sipërfaqe pret rreth 20 ton prodhim.

6. Perimtaria si një sektor vital për punësim dhe gjenerim të të ardhurave

Kultivimi i perimeve vazhdon të ketë një rol të rëndësishëm në krijimin e vendeve të punës dhe gjenerimit të të ardhurave për fermerët që jetojnë në zonat rurale. Në vitet e fundit, ky sektor tregon trende pozitive të rritjes si në sipërfaqe po ashtu edhe në sasi dhe cilësi të prodhimit. Krahas kultivimit të perimeve në fushë të hapur, zonat rurale të Kosovës ofrojnë kushte të përshtatshme për kultivimin e tyre edhe në serra. Pjesa dërmuese e prodhuesve të perimeve në serra karakterizohet me sipërfaqe të vogla, të cilat shfrytëzohen në mënyrë racionale, pavarësisht vështirësive të hasura në vitin 2020 si rezultat i pandemisë.



Duke konsideruar si një sektor me potencial për zhvillim të gjithmbarshëm, IADK ka drejtuar aktivitetet e saj zhvillimore për të mbështetur sektorin e perimeve, në veçanti për të mbështetur të rinjtë, gratë, minoritetet, të rikthyerit dhe grupet e marginalizuara.

Krahas mbështetjes me grante, më saktësisht serra dhe inpute të tjera, një vëmendje të theksuar i është dhënë edhe ngritjes profesionale përmes trajnimeve dhe këshilave praktike për të gjithë përfituesit e organizatës. IADK ka dizajnuar pako atraktive të përshtatshme dhe lehtë të zbatueshme për fermerët – përfituesit, duke mbështetur me serra sipërfaqe nga 100 deri 200 m², përcjellur me sistem të ujitjes, inpute të tjera dhe fidane apo farë të perimeve, si dhe në disa raste edhe motokultivator me frezë për përgatitje të parcelës.

Në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të këtij sektori, IADK ka kontribuar duke ngritur në total afërsisht 1 ha serra me të gjithë inputet përcjellëse.

- 23 përfitues me sipërfaqe nga 100 m²,
- 8 përfitues me sipërfaqe nga 160 m², dhe
- 32 përfitues me sipërfaqe nga 200 m²,

Krahas ngritjes së sipërfaqeve me serrë, është ofruar mundësia e vetëpunësimit për 63 përfitues të këtyre serrave. Pjesa më e madhe e tyre janë të rinjë (35) ose 56% të moshës 18 deri 35, gjinia femërore 30 ose 47 % dhe minoritetet 8 ose 13%.

Stafi IADK-së, ekspertët e saj kanë ofruar këshilla dhe trajnime profesionale me qëllim që përfituesit e serrave të kenë mundësi të shfrytëzojnë serrat në mënyrë racionale dhe të përfitojnë sa më shumë nga kultivimi i perimeve në serra. Afërsia e stafit të IADK-së dhe këshillat e ofruara nga stafi i saj kanë qenë të përhershme, gjithmonë kur është vlerësuar si e nevojshme. Një pjesë e konsiderueshme e përfituesve të projektit kanë arritur të gjenerojnë të ardhura nga shitjet e perimeve, pavarësisht vështirësive të hasura nga pandemia.

Mbështetja e të rinjëve, grave, minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara me serra dhe inpute të tjera është bërë e mundur falë bashkëpunimit dhe financimit nga donatorët si BfdW, GIZ, CFD, DRC dhe komunave partnere.



Bukurije Uka, një nga përfituesit e organizatës IADK e cila është mbështetur me një serrë 200m², inpute të tjera dhe fidane. Znj. Uka ka përfituar këshilla dhe monitorime të vazhdueshme, prandaj edhe ka arritur të prodhoj 1690 kg perime duke i shitur në tregun vendor. Nga shitja zonja ka arritur të gjeneroj të ardhura prej 1,303.50 euro, nga këto të ardhura ajo dhe familja e saj mundohen të bëjnë një jetë më të dinjitetshme.

7. Pemëtaria ofron mundësi punësimi dhe gjenerimi të të ardhurave për të gjithë gjeneratat



Sipërfaqet me pemë çdo vit tregojnë një trend të rritjes pozitive si në aspektin e rritjes së sipërfaqeve, llojllojshmërisë së tyre dhe gjithashtu cilësisë dhe sasisë së prodhimit. Konsiderohet një ndër sektorët me potencial më të lartë për zhvillim dhe përmirësim në Kosovë. Një mundësi e tillë është për shkak të kushteve të përshtatshme agroekologjike dhe pedologjike. Këtë mundësi më së miri e shfrytëzojnë fermerët e vyshëm anekënd Kosovës, përmes mbjelljeve të reja, kujdesin e vazhdueshëm dhe gjithashtu përmes ngritjes së kapaciteteve të tyre profesionale dhe teknike.


Rritja e sipërfaqeve me pemë që rezulton me sasi dhe cilësi adekuate do të ndikojë në zvogëlimin e importit të produkteve si molla, dardha, kumbulla etj. IADK vazhdon të luaj një rol të rëndësishëm në këtë sektor duke ndihmuar dy fermerë me grante që do të rezultojnë me rritjen e sipërfaqeve me dredhëz, boronicë dhe me mekanizëm bujqësorë që do të lehtësojnë punën e fermerëve me pemishtet e tyre.

Krahas granteve IADK ka ofruar edhe programe trajnimi për përfituesit e saj dhe njëkohësisht për të gjithë fermerët të interesuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale në menaxhim, krasitje, kultivim dhe marketing të produkteve. Duke vlerësuar si një nga masat mjaft të rëndësishme krasitjen e pemëve, IADK gjatë vitit 2020 ka organizuar sesion trajnimi praktik për të gjithë të interesuarit në pemtari. Sesioni demonstrues është mbajtur në katër Komuna të Kosovës me 60 pjesmarrës, kryesisht fermerë por edhe me pjesëmarrjen e zyrtarëve komunal.

Kombinimi i trajnimeve praktike në fermë dhe me grante padyshim që do të rezultojnë me pemishte moderne, cilësi dhe sasi që do të plotësojnë nevojat e popullatës.



8. Blegtoria si një sektor premtues dhe me potencial për punësim dhe gjenerim të të ardhurave



Blegtoria vazhdon të jetë një nga sektorët më të konsoliduar në vend, duke ofruar një qëndrueshmëri në aspektin e shitjes së qumështit dhe produkteve të saj. Pavarësisht qëndrueshmërisë dhe përfitimeve që ofron, blegtoria vazhdon të ballafaqohet me vështirësi të theksuar në drejtim të rritjes dhe përmirësimit. Kryesisht, blegtorët e Kosovës mbajnë bagëti për prodhim të qumështit, nga statistikat vlerësohet se në Kosovë janë mbi 130,000 lopë qumështore të cilat arrijnë të prodhojnë mbi 270 milion litra qumësht. Pavarësisht, numrit të lopëve qumështore dhe sasisë së prodhimit, Kosova vazhdon të

importojë sasi të lartë të qumështit nga vendet e ndryshme.

Blegtorët Kosovarë vazhdojnë të ballafaqohen me një mori problemesh nga më të ndryshme, si në aspektin e përmirësimit të racës së lopëve, ofrimin e ushqimeve të nevojshme për lopët qumështore, përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së qumështit, tregut etj.

Adresimi i këtyre vështirësive padyshim që kërkon një angazhim maksimal të të gjithë akterëve, kështu që një rol të rëndësishëm luan edhe organizata IADK përmes programeve të saj.

Gjatë vitit 2020, IADK ka fokusuar intervenimet drejt përmirësimit të cilësisë së qumështit dhe rritjes së sasisë përmes ofrimit të granteve me paisje bujqësore dhe trajnime profesionale e teknike për përfituesit. Ofrimi i mekanizmit bujqësorë si kosë për prerje të barit, pllug për lëvrin, shpërndarëse plehu, laktofrizë etj do të ju mundësojë përfituesve që të rrisin sipërfaqet e tyre dhe njëkohësisht të jenë më racional në punën e tyre.

Muhamed Haradinaj, familjarisht merret me blegtori dhe është një nga përfituesit e IADK-së. Muhamedi ka 12 lopë qumështore dhe deri sa u përzgjedh si përfitues ai nuk ka arritur të nxjerrë më shumë se 10-12 litra qumësht për lopë. Ai u përkrah me mekanizëm bujqësor që i ndihmoi në zgjerim të sipërfaqes punuese dhe diversifikim të kulturave bujqësore për ushqim të kafshëve. Sfidë për Muhamedin ishte prodhimi i ulët i sasisë së qumështit, prandaj ai iu bashkua programit trajnues që e ofroi organizata IADK përmes ekspertëve të saj. Trajnimet teorike dhe praktike, demonstrimet në shtallën e tij dhe puna e palodhshme e Muhamedit kanë ndikuar që sot nga të njejtat lopë qumështore, por duke përmirësuar cilësinë dhe llojin e ushqimit të prodhohet nga 20 deri 25 litër qumësht për lopë.



Krahas blegtorisë, një rëndësi të theksuar i është ofruar edhe fermerëve të cilët merren me zhvillimin e shpeztarisë dhe bletarisë. Bletaria vazhdon të ketë një trend pozitiv të rritjes së vazhdueshme në këto pesë vitet e fundit për 14% duke përfshirë edhe vitin 2020, Krahas rritjeve, ky sektor vazhdon të ballafaqohet me vështirësi të caktuar, në veçanti në sasinë dhe cilësinë e mjaltit. Kështu që, IADK ka mbështetur 9 bletarë me qëllim që të zgjerojnë bletishtet e tyre, përmirësojnë infrastrukturën dhe njëkohësisht të lehtësojnë punën falë pajisjeve të nevojshme si për punë ashtu edhe për

vjelje të mjaltit dhe nënprodukteve tjera. Edhe shpezëtaria ka një trend pozitiv të rritjes në vitete e fundit falë ndihmës nga institucionet publike dhe organizatave të ndryshme. Në këtë drejtim edhe IADK ka mbështetur dy nga përfituesit e saj me inkubator për çelje të vezëve, gjenerator dhe tavolina pune.

Të gjithë përfituesit e projektit në kuadër të blegtorisë janë mbështetur edhe me trajnime profesionale dhe direkte me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale që do të rezultojnë me një shfrytëzim racional të paisjeve të përfituara. Përveç, granteve dhe trajnimeve, IADK ka mbështetur përfituesit e saj edhe me organizimin e vizitave studimore në Kosovë të cilat kanë ndihmuar fermerët që të njihen me praktikën e mira dhe njëkohësisht të ndërtojnë ura komunikuese e bashkëpunuese ndërmjet tyre në aspektin social dhe ekonomik.

9. Strategjia e IADK-së, Objekti i përpunimit dhe Validimi nga Autoritetit Kombëtar i Kualifikimeve

9.1 Strategjia e IADK-së

Gjatë vitit 2020 është finalizuar dhe publikuar Strategjia për periudhën 2020 – 2027. Strategjia është përgatitur nga stafi i IADK-së në mbështetjen e fuqishme nga donatori Brot fur di Welf (BfdW) dhe ekspertët e saj, kjo strategji është aprovuar si dokument funksional dhe zyrtarë nga bordi i drejtorëve të IADK-së.



Strategjia do të shërbej si shtyllë kryesore në punën e IADK-së për vitet e ardhshme, si një instrument mjaft dinamik i cili mund të rishikohet, azhurohet për të akomoduar ndryshimet në nivel institucional, ekonomik dhe ambiental.

Zbatimi i strategjisë do të bëhet nga IADK, kryesisht përmes projekteve, aktiviteteve dhe shërbimeve për të arritur objektivat, planin e punës dhe buxhetin, të gjitha të dizajnuar dhe përgatitura në përputhje me kornizën strategjike që do të kontribuojë në arritjen e vizionit dhe misionit të IADK-së.

9.2 Validimi nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit

IADK edhe në vitin 2020, fokus të veçantë i ka kushtuar programeve të trajnimit për fermerë duke u bazuar në validimin nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), si ofruese e trajnimeve në sektorin e blegtorisë për periudhën tre vjeçare (2019-2022). Janë ofruar trajnime për fermerë, të rinjtë dhe grupet e tjera të interesuar për të përfituar njohuri profesionale dhe teknike në sektorin e blegtorisë. Përmes këtyre programeve janë trajnuar 15 fermerë/blegëtor nga Komuna e Lipjanit, ku 13 prej tyre kanë arritur të çertifikohen dhe kanë marrë titullin "Teknik i Blegtorisë", niveli III sipas AKK, kjo çertifikatë është valide dhe e njohur nga të gjithë institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare. IADK përmes këtyre trajnimeve është duke ndikuar në zhvillimin e sektorit të blegtorisë duke i dhënë fokus të veçantë: I. Cilësisë së qumështit, II. Optimizimit të ushqimit, III. Rritjes së sasisë së qumështit për krerë dhe IV. Përmirësimit të Racës.



Përveç sektorit të blegtorisë, IADK gjatë vitit 2020 ka aplikuar në AKK për akreditimin dhe validimin edhe të programeve të tjera, më saktësisht për përpunim të frutave & perimeve dhe qumështit. Një validim i tillë do t'i mundësojë IADK-së që të rrisë shërbimet në të mirë të qytetarëve të Kosovës, përmes përgatitjes së kuadrove cilësore si në aspektin teorik dhe atë praktikë në sektorin e përpunimit.

9.3 Objekti i përpunimit të frutave & perimeve dhe qumështit



IADK vazhdon të zgjerohet krahas zhvillimit të fuqishëm të bujqësisë. Në këtë kontekst, IADK me ndihmën e donatorit BfdW ka filluar të ndërtoj objektin e përpunimit. Një objekt me sipërfaqe 208m², i cili do të jetë model dhe i vetmi në nivel të Kosovës i llojit të tillë. Objekti do të shfrytëzohet me qëllim ofrimin e trajnimeve praktike për të rinjtë, gratë dhe të gjithë të interesuarit në fushën

e përpunimit të frutave, perimeve dhe qumështit. Objekti do të jetë i pajisur me të gjithë infrastrukturën moderne, me aparaturën e nevojshme bashkëkohore për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e përpunimit.

Ofrimi i një objekti të tillë modern në fushën e trajnimit praktikë dhe ofrimi i kurseve të akredituara dhe validuara do të mundësojë çertifikimin dhe përgatitjen e grupeve të interesit për tregun e punës. Objekti është në fazën e finalizimit dhe do të jetë i gatshëm për operim në pjesën e parë të vitit 2021.

10. IADK përmes fondeve të BE-së përkrah zhvillimin e turizmit dhe krijimin e vendeve të punës për të rinjtë dhe gratë përmes zhvillimit të bujqësisë

10.1 Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm të Kosovës në zonën rurale

Potenciali i lartë i Kosovës për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm duhet të pranohet gjërësisht. Pozicioni i saj gjeografik, trashëgimia e pasur kulturore dhe komuniteti i larmishëm janë përbërësit kryesorë të një oferte të suksesshme dhe tërheqëse turistike.

Për të kontribuar në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, IADK ka filluar zbatimin e një projekti të ri "Transhumanca - ofertë e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi", që financohet nga Bashkimi Evropian përmes programit IPA të bashkëpunimit ndërkufitar në mes Malit të Zi dhe Kosovës. Fusha e projektit përfshinë rajonin e Pejës dhe Istogut, kryesisht malet frymëzuese të këtij rajoni. Me një qasje gjithëpërfshirëse, objektivi specifik i projektit është përmirësimi i vëllimit, cilësisë dhe dukshmërisë së turizmit në lidhje me vlerësimin e trashëgimisë dhe vlerave kulturore dhe natyrore. Transhumanca është traditë e lashtë e migrimit ku njerëzit së bashku me bagëtinë e tyre bëjnë migrim sezonal duke lëvizur në kullotat më të mira të zonave malore, IADK si udhëheqës i projektit në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Zhvillimit për Bjelasica, Komovi dhe Prokletije (RDA KBP) si bashkë-aplikant po punojnë për ruajtjen dhe promovimin e kësaj trashëgimie të përbashkët.



IADK në bashkëpunim me partnerët e saj të projektit do të adresojë disa sfida me të cilat përballen familjet në zonën ndërkufitare, siç janë përmirësimi i kushteve themelore për ofrimin e shërbimeve për turistët, rritjen e kapacitetit të infrastrukturës dhe kapaciteteve shërbyese, promovimi i staneve dhe trashëgimisë kulturore përmes turizmit. Njëkohësisht promovon mundësi të barabarta në mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e biodiversitetit dhe mbështetjen e të rinjëve dhe popullit autokton.

Projekti synon të hulumtoj potencialet për zhvillimin turistik, përmirësimin e infrastrukturës duke përkrahur stanet me panela solar, pika pushimi, zhvillim të shtigjeve tematike që lidhin vendet turistike, materiale promovuese etj. Aktualisht është kryer një studim me 55 familje që kanë potencial për zhvillimin e një oferte të turizmit, rezultatet nga studimi do të paraqiten në formë të shtypur (broshurë).

10.2 Krijimi i vendeve të punës në bujqësi

Punësimi i të rinjëve mbetet sfida dhe kërkesa kryesore që duhet të adresohet. Për adresimin dhe zgjidhjen e tyre, IADK ka filluar të zbatojë projektin "Krijimi i vendeve të punës në bujqësi" projekt 18 muajsh. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian përmes programit IPA të bashkëpunimit ndërkufitar në mes Malit të Zi dhe Kosovës.



Me anë të projektit synohet të përmirësohet çasja në tregun e punës, përmes përkrahjes në aspektin e ngritjes profesionale dhe mbështetjes me grante në bujqësi, të cilat do të kenë ndikim në krijimin e vendeve të punës në bujqësi (BMA) në zonat rurale. Projekti synon të ofroj mbështetje për popullsinë rurale për të maksimizuar shfrytëzimin e burimeve në dispozicion dhe për të siguruar mundësi të ardhurash që do të çojnë në rritjen e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajonit.

Në vitin 2020 është filluar me zbatimin e disa nga aktivitetet promovuse të projektit, pastaj janë përzgjedhur 20 student (10 nga Peja & 10 nga Istogu) të diplomuar në shkencat bujqësore apo teknologjisë ushqimore, të cilët do të sistemohen për kryerjen e punës praktike në kompani që merren me grumbullimin, kultivimin, përpunimin dhe tregëtimin e bimëve mjekësore aromatike, si dhe janë shpallur ftesat për aplikim për trajnime në sektorin e BMA-ve, ku 40 do të përfitojnë nga trajnimet në këtë sektor, ndërsa 20 prej tyre do të përkrahen me grante për kultivim të BMA-ve.

10.3 Mbështetja në punësimin e të rinjve dhe grave në zonat rurale përmes zhvillimit të bujqësisë



Kosova ka popullsinë më të re në Evropë me 50% nën moshën 25 vjeç. Të rinjtë e moshës 15-24 vjeç përbëjnë 31% të popullsisë në moshë pune. Kjo i ofron Kosovës mundësinë për të ndërtuar një forcë të madhe pune dhe të arsimuar. Numri i personave të papunë me arsim universitar dhe diplomë është rritur, duke sinjalizuar një pabarazi midis aftësive të nevojshme në tregun e punës dhe atyre të ofruara nga sistemi arsimor. Rritja e nivelit dhe rëndësisë së aftësive dhe kualifikimeve të forcës së punës është një nga sfidat kryesore. Të rinjtë, gratë dhe grupet në

disavantazh përballen me shumë vështirësi për tu punësuar në sektorin e bujqësisë. IADK ka inicuar zbatimin e një projekti të ri "Mbështetja në punësimin e të rinjve dhe grave në zonat rurale përmes zhvillimit të bujqësisë", që është i financuar nga Bashkimi Evropian. Fusha e projektit përfshin Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe atë të Shtimes. Ky veprim do të kontribuojë në ndihmën e të rinjve, grave dhe grupeve në disavantazh në zonat rurale për krijimin e bizneseve të reja, krijimin e kushteve për t'u vetë-punësuar, sigurimin e përvojës për studentët e papunë dhe për të rritur rolin e zyrave të punësimit.

Për të adresuar çështjen e punësimit të grave dhe të rinjve, IADK përmes projektit synon të ndërmarr një mori aktivitete të cilat kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale për 90 punëkërkuar të regjistruar në zyrat e punësimit në komunat përkatëse. Të mbështes me grante dhe trajnime teknike dhe profesionale në bujqësi për 55 nga të gjithë përfituesit në sektorët bujqësorë me potencial për punësim dhe gjenerim të të ardhurave. Gjithashtu, të ofroj trajnime teknike dhe profesionale përmes praktikës në punë për 20 të rinjë nga komunat e synuara. Po ashtu të fuqizojë zyrat e punësimit përmes ofrimit të infrastrukturës teknologjike për të lehtësuar punën e tyre në shërbim të qytetarëve – punëkërkuarve.

11. IADK ka zgjeruar gamën e operimit duke analizuar sektorin e pylltarisë

Krahas zhvillimit të bujqësisë, IADK ka shtuar fushëveprimin e saj duke analizuar sektorin e pylltarisë përmes mbështetjes financiare të ofruar nga Food Agriculture Organization (FAO). Për këtë qëllim është ndërmarr një studim për vendosjen e pikënisjes për ligjshmërinë e drurit në aspektin ekonomik dhe aspektet gjinore në pylltari. Studimi ka mbuluar katër regjione Pejë, Mitrovicë, Gjiilan dhe Prizren duke targetuar dy kategori atë të familjeve që jetonjë në zonat rurale duke intervistuar 405 familje dhe grupi i dytë atë të bizneseve të lidhur me pylltarinë duke intervistuar 112 biznese të profileve të ndryshme në pylltari. Krahas intervistimeve me anë të pyetësorëve, IADK ka organizuar edhe 8 fokus grupe me akterët relevant për të diskutuar çështjet më në detaje. Studimi i tillë ka gjeneruar një raport mjaft voluminoz me të gjeturat dhe rekomandimet për sektorin e pylltarisë, gjithashtu është përpiluar një hartë GIS për vendet e intervistuara. Raporti me dokumentet tjera përcjellëse do të shërbej për iniciimin dhe vendosjen e hapave kryesore për intervenime në kuadër të sektorit të pylltarisë.



12. Përmbledhje të rezultateve

Pavarësisht se viti 2020 ka qenë një vit mjaft sfidues si rezultat i pandemisë globale me Covid '19, IADK me stafin e saj ka vazhduar të jetë afër fermerëve duke ofruar grante, trajnime dhe këshilla në forma të ndryshme, me qëllim të prodhimit të produkteve bujqësore. IADK ka ndikuar në zhvillimin e sektorëve bujqësor, duke mbështetur të gjithë sektorët me potencial për zhvillim të cilët rezultojnë me punësim, prodhim dhe gjenerim të të ardhurave. Përkundër sfidave të hasura me të cilat është përballuar e gjithë bota, IADK konsideron këtë vit si mjaft të suksesshëm ngase ka shumë rezultate të prekshme dhe të matshme.

Donatori	# përfituesve	Gjinia		Përkatësia etnike		Mosha 18-35
		Burra/djem	Gra/vajza	Shqipëtar	Minoritetet	
BftW	61	47	14	60	1	51
DRC	20	14	6	12	8	2
GIZ-MAP	92	75	17	86	6	31
GIZ-R	41	36	5	39	2	21
CFD	25	6	19	22	3	12
Total	239	178	61	219	20	117

13. Ngritja e kapaciteteve profesionale

13.1 Fuqizimi i fermerëve përmes këshillave direkte dhe trajnimeve profesionale

Kombinimi i ofrimit të granteve me përcjelljen e trajnimeve profesionale padyshim që do të rezultoj me arritjen e rezultateve të prekshme për organizatën e mbi të gjitha për vetë përfituesit. Duke vlerësuar rëndësinë e trajnimeve dhe rolin që luan në zhvillimin e bujqësisë, IADK me stafin e saj cilësor ka dizajnuar programe trajnuese në fusha të ndryshme për interes të përfituesve. Edhe gjatë këtij viti, janë mbajtur një numër i madh i trajnimeve direkte dhe profesionale për sektor të veçantë, trajnime ekonomike, marketingut, të drejtat e njeriut dhe pronës së grave, trajnime për të rinjë dhe studentë etj.

Në total janë organizuar 1627 sesione trajnimi, këshilla direkte dhe trajnime profesionale nga ku kanë marrë pjesë 662 pjesëmarrës si fermerë, studentë, ofrues të trajnimeve dhe zyrtarë nga institucionet lokale.

13.2 Zhvillimi i bujqësisë kërkonë një staf të trajnuar sipas standardeve

Në vazhdimësi bujqësia ka një trend pozitiv të zhvillimit si në aspektin e zgjerimit të sipërfaqeve, shumëllojshmërisë së kulturave, sasisë dhe cilësisë së prodhimit. Padyshim, një rol të rëndësishëm kanë ekspertët ose ofruesit e trajnimeve që me kapacitetet e tyre profesionale ndikojnë në zhvillim të mëtutjeshme të bujqësisë.

Zhvillimi dhe avancimi i njohurive të stafit vazhdon të mbetet një nga pikat kryesore, prandaj gjatë vitit 2020, 8 nga stafi i saj ka ndjekur trajnime të avancuar nga ekspertja ndërkombëtare Birgit Bohr me temat kryesore në bujqësi organike, dhe në fund secili nga pjesëmarrësit kanë arritur të certifikohen si njohës të bujqësisë organike për BMA.

Gjithashtu, 6 nga stafi teknike dhe menaxherial kanë përcjellur trajnimet e ofruar nga MBPZHR në kuadër të programit për certifikim të këshilltarëve për bujqësi dhe zhvillim rural. Në fund të trajnimit stafi pjesëmarrës i është nënshtruar testit me që rast edhe janë paisur me certifikatë.

14. Publikimet

Me qëllim që të informojë sa më shumë aplikuesit potencial në zonat më të thella rurale, IADK ka përgatitur fletëpalosje informuese për projekte të ndryshme që janë duke u zbatuar me një një shtrirje në tërë Kosovën. Gjatë viti 2020 janë përgatitur dhe publikuar broshura të ndryshme, të cilat janë përkrahur financiarisht nga donatorët.

Gjithashtu, janë përgatitur dhe publikuar dy video reportazhe në kuadër të dy projekteve të mbështetur nga GIZ:

Projekti për të rikthyer: <https://www.youtube.com/watch?v=tKJIRhH20wl> dhe

Projekti për bimë mjekësore: <https://www.youtube.com/watch?v=YNnRYx5ZkP4>



15. Vizitat lokale dhe regjionale

Edhe pse viti 2020 ka pasur shume sfida sa i përket grupimeve në masë dhe realizimit të aktiviteteve në teren si shkak i pandemisë COVID-19, IADK duke përcjelluar masat e dala nga IKSHPK dhe ka vazhduar me realizimin e vizitave studimore lokale dhe regjionale në grupe më të vogla me qëllim shkëmbimit të përvojave ndërmjet fermerëve, njohjes me praktikat e mira bujqësore në sektorë të ndryshëm bujqësorë. Këto aktivitete janë mbështetur nga donatorët e organizatës si CFD, DRC, GIZ dhe UNDP.



Vizitat Studimore



16. Eventet për diskutim, identifikim dhe adresim të problemeve, promovim dhe publikim të aktiviteteve

Përkundër vështirësive të shfaqur si rezultat i pandemisë, IADK ka vazhduar të diskutoj, identifikoj dhe adresojë problemet dhe vështirësitë për zhvillimin e bujqësisë. Gjithashtu, identifikimin e kërkesave për përfshirjen e grave, të rinjëve dhe grupeve të marginalizuara në aspektin ekonomik dhe social. Gjatë vitit 2020, IADK ka organizuar tryeza të rrumbullakëta, konferenca e ceremoni në forma të ndryshme në vartësi të kushteve të lejuara si rezultat i pandemisë. Gjatë kohës së kufizimeve të imponuara nga Institucionet Shtetërore, IADK për organizimin e eventeve të tilla ka gjetur mënyra të tjera përpos atyre me pjesëmarrje fizike edhe përmes platformave online duke përdorur platformën komunikuese Zoom.



Gjithsej janë organizuar 7 tryeza të rrumbullakët me 104 pjesëmarrës, një konferencë (49 pjesëmarrës) dhe një ceremoni përvurimi (50 pjesëmarrës). Eventet e tilla janë bërë të mundur falë mbështetjes financiare nga donatorët e ndryshëm si UNDP, GIZ, CFD dhe BftW. Përpos këtyre eventeve, IADK në mbështetje të donatorit FAO ka organizuar edhe 8 fokus grupe me 67 pjesëmarrës për të diskutuar problemet kryesore në sektorin e pylltarisë, vështirësitë në këtë sektor në aspektin e ligjshmërisë së drurit, aspektin gjinor dhe rëndësinë ekonomike të këtij sektori.

17. Të hyrat e IADK-së nga donatorët për vitin 2020


Viti 2020 është viti më i suksesshëm në historinë e IADK-së në realizimin e aktiviteteve po ashtu edhe në krijim të të ardhurave edhe pse ka pasur sfida në zbatim të projekteve si shkak i pandemisë COVID-19. IADK ka treguar një qëndrueshmëri financiare, të hyrat gjatë këtij viti janë 2,197,234€. Të hyrat e tilla janë krijuar falë punës voluminoze dhe transparencës së treguar, me që rast është ndërtuar edhe një besueshmëri e theksuar me donatorët e ndryshëm. Regjistrimi dhe menaxhimi i të hyrave nga donatorët, organizatat dhe partnerët tjerë do të ishte i vështirë pa ndërtimin e një sistemi të mirë dhe të avancuar, prandaj IADK gjatë vitit 2020 ka bërë investime që sistemi aktual të jetë i versioneve të fundit dhe lehtë i përdorshëm.

Shfrytëzimi i QuickBooks, rëndësia e tij dhe lehtësirat që ka ofruar

Në këto kohë nuk mund ta imagjinosh menaxhimin financiar pa një software të përshtshëm e të kompletuar. IADK ka pasur fatin që të bashkëpunojë tashmë 10 vite me Melita&Partners të cilët ofrojnë software-in Quickbooks, i cili ka lehtësuar shumë punën tonë në këtë aspekt.

Duke marrë parasysh dinamikën e madhe të punëve dhe aktiviteteve që zhvillohen në organizatën tonë, atëherë shfrytëzimi i një produkti siç është Quickbooks, është më se i domosdoshëm. Ky software na mundëson të kemi kontrollë të plotë në shpenzimet e përditshme që ndodhin tek të gjitha projektet në implementim, e gjithashtu në çdo moment kohe mund të gjenerohen raporte të cilat japin një pasqyrë të saktë të gjendjes momentale të organizatës.


Në mesin e shumë ngjarjeve që mund ta karakterizojnë vitin 2020 si mjaft të suksesshëm për organizatën tonë, është pikërisht edhe përditësimi i software Quickbooks i cili ka ndodhur në një moment shumë të rëndësishëm meqenëse pikërisht gjatë këtij viti është shtuar numri i projekteve në zbatim. Kontrolli dhe menaxhimi i këtyre projekteve dhe organizatës në tërësi është bërë shumë më efikas dhe eficient falë përdorimit të këtij software-i.



Nr	Emri i Donatorit	Emri i Projektit	Shuma €	Përqindja
1	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH	Mbështetja e zinxhirit të vlerave të MHAP përmes krijimit të punësimit dhe vazhimit të eksportit	816,869	45.06%
	Fermerët - Përfutuesit		173,225	
2	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH	Përfshirja ekonomike e të kthyerve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes formimit profesional	99,881	6.02%
	Komunat (Rahovec, Vushtrri, Klinë) dhe Përfutuesit		32,369	
3	Bread for the World	Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës	355,700	18.78%
	Komunat (Shtime, Vushtrri, Skenderaj, Viti Kamenicë, Lipjan) dhe Përfutuesit		57,023	
4	Këshilli Danez për Refugjatë (DRC)	Mbështetja e Ndërmarrësisë Shoqërore dhe Promovimi i Fuqizimit Social -ekonomik në Komunitetet Minoritare në Kosovë	98,698	4.70%
	Fermerët - Përfutuesit		4,496	
5	Organizata Feministe e Paqes-cfd	Aftësi profesionale dhe mundësi gjenerimi të të ardhurave në bujqësi për gratë dhe të rinjtë që jetojnë në zonat rurale të Kosovës	73,000	3.85%
	Komunat (Vushtrri, Mitrovicë) dhe Përfutuesit		11,550	
6	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)	Mbështetja e grave dhe vajzave në fuqizimin ekonomik përmes vetë-punësimit dhe ngritjes së aftësive të tyre profesionale	1,500	0.07%
7	Zyra e Bashkimit European në Kosovë	Krijimi i punësimit në bujqësi	106,816	4.86%
8	Zyra e Bashkimit European në Kosovë	Tran shumanca - ofertë e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi	204,992	9.33%
9	Zyra e Bashkimit European në Kosovë	Mbështetja e punësimit të të rinjëve dhe grave në zonat rurale përmes zhvillimit të bujqësisë	151,115	6.88%
10	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi (FAO)	Mbledhja e të dhënave për krijimin e bazës bazë për ligjshmërinë e drurit dhe aspektin ekonomik të sektorit pyjor në Kosovë	10,000	0.46%
Total			2,197,234	100%

18. Të hyrat e IADK-së nga partnerët për vitin 2020

Përveç të hyrave nga donatorët, IADK gjatë vitit 2020 ka pasur të hyra edhe nga partnerët tjerë, kryesisht nga organizata dhe komunat partnere ku janë realizuar aktivitetet që për qëllim ka mbështetjen e fermerëve – përfutuesve në sektorët e ndryshëm të bujqësisë.



Nr.	Emri i Partnerit	Emri i Projektit	Shuma €	Përqindja
1	Zyra e Bashkimi European në Kosovë	Ndihma teknike për monitorimin e Skemës së Granteve për Mbështetjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural IPA 2015	9,213	20.66%
2	Komuna e Shtimës	Shërbimet Këshillimore dhe Trajnimet për fermerë	2,160	4.84%
3	Bioma	Trajnime	1,294	2.90%
4	Komuna e Lipjanit	Shërbimet Këshillimore dhe Trajnimet për fermerë	1,800	4.04%
5	Komuna e Vushtrrisë	Shërbimet Këshillimore dhe Trajnimet për fermerë	3,960	8.88%
	Komuna e Vushtrrisë	Bashkëfinancimi në ndërtimin e objektit shtesë-njësisë përpunuese	6,000	13.46%
6	Komuna e Mitrovicës	Shërbimet Këshillimore dhe Trajnimet për fermerë	1,236	2.77%
7	Komuna e Kamenicës	Shërbimet Këshillimore dhe Trajnimet për fermerë	1,800	4.04%
8	Komuna e Skënderajt	Shërbimet Këshillimore dhe Trajnimet për fermerë	2,520	5.65%
9	Swisscontact Kosovo	Shërbimet Këshillimore për Kultivimin e BMA	585	1.31%
10	Caritas	Zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik rural	13,750	30.84%
11	Fermeri	Gjeneratori automatik	269	0.60%
Total			44,587	100%

19. Lista e stafit të IADK-së për vitin 2020

Padyshim, zbatimi i një numri të madh të projekteve e aktiviteteve dhe ofrimi i rezultateve të prekshme nuk do të bëhej i mundur pa një staf të përkushtuar dhe cilësor. Rol në arritjen e rezultateve të përmendura në raport kanë stafi si në vijim:

Zenel Bunjaku	Behare Mlinaku
Esma Azemi Kepuzi	Albina Tahiri
Ariana Peci	Besarta Hajrizi
Elheme Shala	Fidan Skeraj
Fjolla Zuçaku	Gëzim Murseli
Petrit Koci	Hasan Cena
Shkurte Bunjaku	Halit Gashi
Sylejman Bunjaku	Leart Kamberi
Novica Markovic	Sadie Hasani
Hanumshahe Zeneli	Ferki Surdulli
Hafize Veseli Sylejmani	Nexhmedin Melenica
Egzon Gërxhaliu	Arlindë Hyseni
Egzona Hajra	Gonxhe Dobroshi
Ema Kurshumlija	Labinot Kryeziu
Edita Mahmuti Mula	Elion Gërguri
Basri Pulaj	Leonora Hajra
Argjend Gjinojci	Egzon Ismajli

T ë jetojmë nga toka dhe puna jonë

Adresa:

Sfaraçak i Ulët, Nr.11,
42000 Vushtrri,
Kosovë

E-mail: info@iadc.org

Tel: +383 (0) 44 777 036

+383 (0) 49 777 046

Web: www.iadc.org

